



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr 288/prot

Laç më 30/01 2024

VENDIM

Nr. 09, Datë 25/01 /2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR., 19, DATË 21.07.2023 “PËR NGRITJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KËSHILLIT BASHKIAK KURBIN”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54, germa a, si dhe në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit Bashkiak Kurbin, miratuar me VKB nr. 50, datë 26.02.2020, si dhe në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, pas propozimit nga Kryesia e Këshillit dhe grupet e këshilltareve, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Integrimit Europian me këtë mision:
 - a. Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në BE. Të monitorojë programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
 - b. Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian cili hartohet dhe raportohet cdo vit kalendarik.
 - c. Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë me mbështetjen e strukturës së Integrimit Europian organizojnë në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-së.
 - d. Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
 - e. Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.
2. Anëtarët e Komisionit me propozimet e grupeve të këshilltarëve janë si më poshtë:

1.z.Diogjen Kolici
2.znj.Melisa Kalaja
3.z.Aleksander Jakaj
4.znj.Albana Gjeta

5.z.Rinaldo Piroli
6.znj.Gëzime Veseli
7.z Altin Bruka

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes .

Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryesia e Këshillit Bashkiak.

>Prefektit Të Qarkut Lezhë

>Arkivi

Sekretari i Këshillit
Arber Leka



Kryetari e Këshillit
Edlira Lleshi

